

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. BLENDAR ABDULLAI

07/30/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 26.07.2018 për subjektin e rivlerësimit, z.Bledar Abdullahi, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 30.07.2018, vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit , Bledar Abdullahi, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjykuese e kryesuar nga znj. Genta Tafa (Bungo), znj.Suela Zhegu relatore, znj.Pamela Qirko anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë.

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.